



Planuar / Dorezuar Prijemno/Prudato Received / Delivery	23 - 12 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMTSACK	8410/2022		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.986/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.986/2022, të datës 09.11.2022 të ankuesit

Komuna e Ferizajt, kundër Njoftimit të rezultateve përfundimtare të vlerësimit të datës shpallura organit të punësimit Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.12.2022, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.986/2022 e datës 09.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Njoftimi për Rezultatet përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm i datës 03.10.2022, ndërsa Anulohet në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 18.07.2022 me numër të Referencës: RN00009496 për emrin e grupit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm", për të tre (3) pozitat: "Asistent Administrativ"; "Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme" dhe "Zyrtar për Gjendje Civile 4".
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi Musa Muhaxheri, e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë në procedurën e rekrutimit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" të shpallur nga Komuna e Ferizajt, me datë 08.11.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 09.11.2022 dhe është protokolluar me numër 66932/2022, kundër njoftimit të datës 10.10.2022 lidhur me shpalljen rezultateve përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka zbatuar gabimisht dispozitat a aplikuar ligjore me rastin e vlerësimit të biografisë së ankuesit nuk i ka marr për bazë njohuritë dhe përvojën të paraqitura në CV, me kërkesën që konkursi të anulohet ose lënda të kthehet në rivlerësim te Komisioni i Pranimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Ferizajt. Ndërsa me datë 22.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 09.11.2022 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimi përfundimtarë për kandidatët fitues i datës 10.10.2022; E-mail i dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për ankuesin i datës 10.10.2022; E-mailin e ankuesit të datës 08.11.2022 dërguar në Këshill me shkresat e bashkangjitura të ankesës; E-mailin e ankuesit të datës 09.11.2022 dërguar në Këshill; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 03.10.2022; CV-në e ankuesit; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Njësine e Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.11.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.11.2022; Shkresën e cila paraqet fazën e procedurës së rekrutimit sipas sistemit të njesisë së burimeve njerëzore; Rezultatin e vlerësimeve përfundimtare me kandidatit fitues i datës 03.10.2022; Rezultatin e vlerësimeve i datës 27.09.2022; Konkursin e shpallur të datës 18.07.2022 me numër të Referencës: RN00009496; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit i datës 19.08.2022; Listën e përgjithshme të aplikantëve; Listën e aplikantëve të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit; Listën e kandidatëve që nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit; Listën përfundimtare të datës 05.09.2022 lidhur me kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret e konkursit; Njoftimin e datës 31.08.2022 lidhur me aplikacionet e pranuar; Formularin e vlerësimeve përfundimtare i datës 03.10.2022; Formularët e vlerësimeve të kandidatëve në procedurë; Aplikacionin e kandidatës Jehona Mehmeti të datës 15.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës Hazire Salihu të datës 19.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës Shkurte Tahiri të datës 23.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit Elbasan Osmani të datës 15.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës Hazire Ismajli të datës 09.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës Afërdita Jakupi të datës

17.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e ankuesit të datës 19.08.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, SEPSE:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Ferizaj me datë 18.07.2022 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për emrin e grupit "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" me numër të Referencës: RN00009496, për tre (3) pozita, si vijon: "*Asistent Administrativ - profesional 3*"; "*Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme - profesionale 2*" dhe "*Zyrtar për Gjendje Civile 4- profesional 3*", ndërsa bazuar në aplikacionin e ankuesit të datës 19.08.2022 konstatohet fakti se ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër të Referencës: RN00009496. Ndërsa përveç ankuesit, në këtë procedurë të rekrutimit kishin aplikuar gjithsejtë gjashtëdhjetë e pesë (65) kandidatë, prej tyre pas fazë së verifikimit paraprak dhe procedurave ankimore njëzet e pesë (25) kandidatëve iu është refuzuar aplikacioni në këtë fazë për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të konkursit.

Ankuesi, gjatë fazës së vlerësimit të biografisë, i pakënaqur me vlerësimin e bërë nga Komisioni i Pranimit kishte parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni i pranimit përmes Vendimit të datës 03.10.2022 kishte nxjerr Vendimin nr.01-142/22 përmes të cilit e kishte refuzuar ankesën e ankuesit ndërsa kishte lënë në fuqi vlerësimet përfundimtare të kandidatëve, kështu që pas përfundimit të fazës së ankesave të brendshme me datë 03.10.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore nxjerr rezultatin përfundimtar lidhur me kandidatët e suksesshëm për pozitat e shpallura të konkursit nga rezulton se ankuesi nuk ishte kandidat i përzgjedhur, ndërsa në pajtim me dispozitat e aplikuara ligjore përmes e-mailit të datës 10.10.2022 e kishte njoftuar ankuesin lidhur me kandidatët fitues me këshillën e dhënë juridike se brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin e shpallur të datës 18.07.2022, për grupin "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" me numër të Referencës: RN00009496 për të tri (3) pozitat e shpallura nga Komuna e Ferizajt, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve Universitare-në Juridik, ose Administratë Publike, me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvoja pune.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kërkesën e tij për anulimin e konkursit për shkak të vlerësimeve se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të tij ka vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara, me qëllim shqyrtimit të ligjshmërisë të procedurës së rekrutimit, që prej momentit të shpalljes së konkursit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin

e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil neni 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Për qëllim të organizimit të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës pozitat e kategorisë profesionale grupohen sipas natyrës të pozitës në: 1.2. grupin e pozitave të administrimit të përgjithshëm. 3. Grupi i pozitave të administrimit të përgjithshëm përfshin të gjitha pozitat që nuk janë pjesë e një grupi të administrimit të posaçëm dhe që kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësi, të përgjithshme administrative, kryerja me sukses e të cilave kërkon njohuri dhe aftësi të përgjithshme administrative, të cilat nuk burojnë apo lidhen domosdoshmërisht me zotërimin e një ose disa profesioneve të caktuara" ndërlidhur me Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, renditja numër 58 e Grupit- Specialist i Administrimit të Përgjithshëm Arsim i lartë i paspecifikuar, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Ferizajt me rastin e shpalljes së konkursit të datës 18.07.2022, me numër të Referencës: RN00009496, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material lidhur me përcaktimin e kriterëve të kualifikimeve profesionale, pasi që për grupin e pozitave "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" kërkohet vetëm arsimimi i lartë dhe nuk është i specifikuar, ndërsa në konkursin e kontestuar kanë qenë të përcaktuara si kriter, Diplomë/a Universitare, të studimeve Universitare-në Juridik, ose Administratë Publike.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për secilën klasë në shërbimin civil të Kosovës, pozita sipas klasës Profesional 3, lidhur me kushtet e përgjithshme formale të punës sa i përket përvojë së punës ku përcaktohet se: "Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Ferizajt me rastin e shpalljes së konkursit të datës 18.07.2022, me numër të Referencës: RN00009496, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material lidhur me përcaktimin e kriterëve të kualifikimeve profesionale, pasi që për postat e shpallura të kategorisë profesionale, "Asistent Administrativ - profesional 3"; dhe "Zyrtar për Gjendje Civile 4- profesional 3", në kriteret e konkursit është kërkuar 2 (dy) vite përvojë pune, ndërsa sipas dispozitave të kësaj rregullore për këto dy pozitat të përcaktuara në kategorinë profesionale, Profesional 3 nuk kërkohet përvojë pune.

Bazuar si më lartë, nga shkresat e administruara të lëndës si dhe gjetjeve të shkeljeve të rregullave dhe parimeve të pranimit në shërbimin civil lidhur me përcaktimin e kriterëve të konkursit të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Ferizajt me rastin e shpalljes së konkursit të pranimit (i jashtëm) të datës 18.07.2022 për emrin e grupit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" me numër të Referencës: RN00009496, për tre (3) pozita, si vijon: "Asistent Administrativ - profesional 3"; "Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme - profesionale 2" dhe "Zyrtar për Gjendje Civile 4- profesional 3", ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "1. Pranimi në detyrë i nëpunësit Civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e

kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.”, pasi që me rastin e shpalljes së konkursit kishte përcaktuar kriteret e përgjithshme formale sa i përket arsimimit dhe përvojës së punës në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, andaj mbi këtë Kolegji i Këshillit njëzëri ka vendosur që proceduar e kontestuar përmes kësaj ankese të anulohet në tërësi, gjegjësisht Rezultati i vlerësimeve përfundimtare me kandidatët e suksesshëm i datës 03.10.2022 është shfuqizuar, ndërsa Konkursi i shpallur me datë 18.07.2022, për grupin “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” me numër të Referencës: RN00009496 për të tri (3) pozitat e shpallura është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, nga rrjedh se kërkesa e ankuesit për anulimin e konkursit është e bazuar në ligj.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se me rastin e hapjes së konkursit të kontestuar me këtë ankese nuk janë përfillur parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, ka vendosur njëzëri se përbën bazë të mjaftueshme ligjore që konkursi të anulohet në tërësi, ndërsa nuk është lëshuar në shqyrtim e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit për asnjë fazë tjetër të rekrutimit apo veprim procedural, pasi që nuk do të kishte asnjë efekt të ndryshëm juridik.

Kolegji i Këshillit, po ashtu thekson faktin se për objektin e njëjtët të kësaj çështjes administrative ka nxjerrë edhe Vendimin A.nr.965/2022 të datës 13.12.2022 dhe A.nr.908/2022 i datës 09.12.2022 mbi bazën e të cilëve nuk ishte anuluar i gjithë konkursi, ndërsa deri te natyra e vendimmarrjes së tillë kishte ardhur për shkak se palët-ankuesit nuk kishin pretendime ankimore të anulimit konkursit për shkak të shkeljeve të pasqyruar si më lartë, andaj mbi këtë bazë meqenëse përmes këtij Vendimi A.nr.986/2022 Këshilli ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit për shkak të kërkesës së palës dhe ka gjetur se ka shkelje të parimeve të përgjithshme të pranimit në Shërbimin Civil, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa dy vendimet paraprake të Këshillit nuk prodhojnë detyrime të tjera juridike apo veprime administrative për palët në procedurë, pasi që sipas këtij vendimi të përcaktuar si në dispozitiv, konkursi i datës 18.07.2022 për grupin “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” me numër të Referencës: RN00009496 për të tri (3) pozitat është anuluar në tërësi, ndërsa Kryetari i Komunës së Ferizajt obligohet të veprojë në pajtueshmëri me gjetjet e dhëna në këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.986/2022

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Estref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Ferizajt*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*